



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË**

RELACION

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE 2024
DHE PLANIT TË KONSULTIMEVE PUBLIKE 2024 TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË**

Të nderuar Këshilltarë!

Paraqesim përpara jush planin e aktiviteve dhe të konsultimeve të Këshillit të Bashkisë Korçë për vitin 2024.

Ky plan është hartuar në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, Për vetëqeverisjen vendore” dhe neneve 59, pika 1, gërma e), neni 70, pika 1, paragrafi 2, neni 117, pika 1 dhe neni 123 të Rregullores së Këshillit të Bashkisë Korçë. Këto dispozita japin të drejtën Këshilli të hartojë Planin e punës dhe organizojë aktivitetin e tij 1 vjeçar.

Ky plan është hartuar duke konsideruar praktikat më të mira të Këshillave vendorë me mbështetjen e projektit Bashki të Forta dhe konsultimeve të vazhdueshme me Kryetarin e Këshillit dhe Sekretaren e Këshillit.

Hartimi i planit të aktiviteteve dhe të konsultimeve synon përcaktimin e një kornize orientuese mbi punën dhe aktivitetin e Këshillit të Bashkisë Korçë duke pasur parasysh fuqizimin, ruajtjen e autonomisë së këshillit, si edhe siguron ushtrimin e funksionit legjislativ si organ përfaqësues, vendimarrës, mbikëqyrës e monitorues.

Theksjomë se ky plan aktivitetesh dhe plani i konsultimeve është orjentues dhe mund të ndryshojë për çdo emergjencë, apo situatë të paparashikueshme në momentin e hartimit të tij.

Çdo ndryshim i tij nëpërmjet vendimarrjes, apo zhvillimit të aktivitetit të paparashikuar do të pasqyrohet në këtë plan dhe do të jetë objekt i monitorimit të performacës së Këshillit dhe do raportohet si i tillë në fund të vitit pa pasur nevojë të zhvillohet procesi I vendimarrjes duke e ndryshuar këtë plan.

E rëndësishme është se ky plan aktivitetesh është baza për të hartuar buxhetin e shpenzimeve të Këshillit të Bashkisë, i cili do negociohet me Kryetarin e Bashkisë dhe të jetë pjesë e buxhetit total të Bashkisë Korçë, si një kapitull më vete.

Mendojmë se sygjerimet tuaja mbi aktivitete konkrete të cilat mund të shtohen/ndryshohen mbi këtë draft të paraqitur do të jenë shumë me vlerë dhe kontribuese për një plan aktivitetesh sa më të mirë.

Duke besuar në mendimet, sugjerimet tuaja ju ftojme në diskutime dhe votim.

Ju Faleminderit!

Kryetari I Këshillit

Ana VERUSHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

PROJEKT VENDIM

Nr: _____, datë ____/____/2023

PËR MIRATIMIN E PLANIT TË AKTIVITETEVE 2024
DHE PLANIT TË KONSUKLTIMEVE PUBLIKE 2024 TË KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË

Bazuar në nenin 54 pika a të ligjit nr. 139/2015, Për vetëqeverisjen vendore” dhe neneve 59, pika 1, gërma e), neni 70, pika 1, paragrafi 2, neni 117, pika 1 dhe neni 123 të Rregullores së Këshillit të Bashkisë Korçë me propozim të Kryetarit dhe Sekretarit të Këshillit,

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e Aktiviteteve 2024 dhe Planin e Konsultimeve Publike të Këshillit të Bashkisë Korçë për vitin 2024 bashkangjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Këshilli Bashkiak.
3. Ngarkohet Kryetari i Këshillit dhe Sekretariati për të hartuar buxhetin e Këshillit të Bashkisë për vitin 2024 në zbatim të këtij plani aktivitetesh dhe ta paraqesin për miratim së bashku me buxhetin e Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETARE

Ana VERUSHI